25003

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 25003 VENDIMI

**VENDIM**
**PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Ne Tirane,sot me date,22 01.2001,une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane-: Anila Cofo,pasi morra ne shqyrtim materialet e paraqitura nga kerkuesi,per Rregjistrimin e Shoqerise Tregtare"DEDA" SH.P.K:

**KONSTATOVA:**

Se me date: 18.01.2001 ,eshte themeluar ,shoqeria tregtare,"**DEDA"**SH.P.K,me Ortak te vetem themelues z VELI DEDA me Kapital fillestar 100.000(njeqind mije)leke,kohezgjatje me afat te pacaktuar e mbi 15 vjet,me Seli ne qytetin e Peshkopise.,Lagja e Re

**Objekti** ekonomik dhe aktiviteti I kesaj shoqerie do te jete:
Roje Civile
Ruajtja e objekteve Civile dhe ushtarake.
Ruajtja e personave fizike dhe juridike,vendas e te huaj.

**PER KETO ARESYE :**

Meqenese kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare",dhe ne Ligjin 7667 date 28.01.1993,"Per Rregjistrin Tregtar",

**VENDOSA:**

Te miratoj kerkesen per Rregjistrimin e Shoqerise Tregtare "DEDA" SHPK,me Ortak te saj te vetem dhe Administrator z.VELI DEDA.Me kapital themeltar 1000.000(njeqind mije) Leke,me kohezgjatje te pacaktuar e mbi 15,me Seli ne Peshkopi,Lagja e Re.
-**Objekti** ekonomik dhe aktiviteti I kesaj shoqerie do te jete:

- Roje Civile
- Ruajtja e Objekteve Civile e Ushtarake
- Ruajtja e personave fizike e juridike vendas e te huaj.
- -Administrator I Shoqerise do te jete z.**VELI DEDA**

-Kunder ketij Vendimi mund te behet ankim.

**GJYQTARE**
Anila Cofo

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE**
**Nr.** 25003/1 **vendimi.**

**V E N D I M**
**I**
**GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 20 .04.2005 une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, .....B. Lesuga...., mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z.Veli DEDA, ne cilesine e administratorit te shoqerise "DEDA" SHPK dhe

**KONSTATOVA SE:**

Shoqeria "DEDA,, SHPK eshte rregjistruar prane rregjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr 25003 date 22.01.2001

Ortaku i vetem i shoqerise ne date 19.04.2005 vendosi:

1. Ndryshimin e emrit te shoqerise nga "DEDA" ne "KEVENJO" SHPK.
2. Emerimin e Z. Ismet CANI ne detyren e drejtuesit teknik te shoqerise.
3. Rritjen e kapitalit te shoqerise ne 4.000.000 leke
4. Zgjerimin e objektit te shoqerise me: Ushtrim aktiviteti te sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike kategoria A + B.
5. Depozitimin e ketij vendimi prane Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me siper, nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa dhe aktet e tjera jane ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet te pranohet.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te Ligjit Nr.7667 date 28/01/1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

**V E N D O S A**

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit date 19.04.2005 te ortakut te vetem te shoqerise nga i cili rezulton se shoqeria quhet « KEVENJO » SHPK, ushtron aktivitet te sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike kategoria A+B dhe ka kapital prej 4.000.000 leke.
- Te behen shenimet perkatese ne rregjistrin tregtar ..................
- Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit.

**G J Y Q T A R**

Blerina Lesuga

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 25003/2 vendimi.

# VENDIM
# I
# GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 15 .12.2005 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ........................., mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z.Veli DEDA ne cilesine e administratorit te shoqerise "KEVENJO,, SHPK dhe

## KONSTATOVA SE:

Shoqeria "KEVENJO,, SHPK eshte rregjistruar prane rregjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr. 25003 date 2001.

Ortaku i vetem i Shoqerise Veli DEDA ne date 07.12.2005 vendosi:

1. Emerimin e Z.Selman Hysen LEKA si drejtues teknik teknik i shoqerise.
2. Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me siper, nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa dhe aktet e tjera jane ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr.7667 date 28/01/1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

## VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit te Ortakut te Vetem te Shoqerise "KEVENJO" SH.P.K.
- Te behen shenimet perkatese ne rregjistrin tregtar ………………..
- Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit.

GJYQTAR

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**G.IYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
Nr. 25003/3 **vendimi.**

# V E N D IM

## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 13.12.2006 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, ........................, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Z.Veli DEDA ne cilesine e administratorit te shoqerise "KEVENJO,, Sh.p.k. dhe

## KONSTATOVA SE:

Shoqeria "KEVENJO,, Sh.p.k. eshte rregjistruar prane rregjistrit tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin nr. 25003 date 22.01.2001.

Ortaku i vetem i Shoqerise "KEVENJO" Sh.p.k. ne date 16.11.2006 vendosi:

1. Emerimin e Z. Nesim NDREU ne detyren c Drejtuesit Teknik te Shoqerise per kategorine a + b.
2. Largimin e Z.Selman LEKA nga detyra e Drejtuesit Teknik te Shoqerise per kategorine a+b.
3. Ngarkohet administratori i shoqerise Z. Veli DEDA te kryeje te gjitha procedurat e nevojshme per depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me siper, nga materialet e paraqitura rezulton se kerkesa dhe aktet e tjera jane ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet te pranohet.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr.7667 date 28/01/1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitete qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise "KEVENJO" Sh.p.k. date 16.11.2006
Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin tregtar......................
Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit.

**G J Y Q T A R**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE**
**NR.___________Vendimit**
25003/4

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 25/7/.2007 une gjyqetarja R. Bajcb ______ e rrethit gjyqsor Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura nga
**KERKUESI:**
**Veli Deda,** Administrator i shoqerise **" KEVENJO" sh.p.k.**

**K O N S T A T O V A:**

Se me Vendimin date 16.07.2007 te Ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KEVENJO" sh.p.k ( e njohur si person juridik me Vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane Nr Nr. 25003 date 22.01.2001 shoqeria "DEDA" sh.p.k. e cila me vendim te gjykates se rrethit gjyqsor nr 25003/1 date 20.04.2005 ka ndryshuar emrin ne "KEVENJO" sh.p.k.**, me ortak te vetem Z.Veli Deda**), mbeshtetur edhe ne Statutin e Shoqerise eshte vendosur, ndryshimin e Drejtuesit teknik te shoqerise .
1-Shkarkohet nga detyra e drejtuesit teknik Z. Nesim Ndreu.
2-Emerohet ne detyren e drejtuesit teknik Z. Qemal Fisniku i biri i Basimit dhe i Lumijes i datelindjes 06.11.1955, lindur ne Peshkopi dhe banues ne Tirane ne Kombinat Rr" Qelqit " Nj. 6.
Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore .

**PER KETO ARESYE :**

Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te Nenit 24 te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "Per Rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtare"

**V E N D O S A:**

Te urdheroj zyren e Regjistrit Tregtare per te depozituar Vendimin e Ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **" KEVENJO" sh.p.k.**
Te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen 8, 5 . rreshtin . Kopja e vendimit t'ju dergohet subjekteve te interesuara.

Tirane,me 25/7/ 2007

**G J Y Q T A R E**
Rezarta Bajcb

# Urdher - Regjistrimi

25003

Emertimi i Shoqerisë : "DEDA" shpk

Selia e shoqerise : Lagjja e Re, Peshkopi

Kapitali : 100.000 lekë

Kohezgjatja : mbi 10 vjete

Ortaket e shoqerise : ortaku i vetem z. Veli Deda

Administrator : z. Veli Deda

Objekti i veprimtarisë : Roje civile, ruajtje e objekteve civile ruajtje e personave fizike e juridike nen e te huaj.

Data e nenshkrimit : 18.01.2001.

Data e regjistrimit : .01.2001.

Akti i Themelimit : 2(dy) flete

Statuti : 5(pesë) flete + vertetimi noterial

**Shenime** : kapitali i shoqerise i derdhur në Banken e Kursimeve (Sh.A) dega Peshkopi, data 16 janar 2001 me kartelen 8580/1

Gjyqtare

Anila Capo

**AKT-THEMELIMI**
(KONTRATE)
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI**
**TE KUFIZUAR**
**" DEDA"SH.P.K**

Une ,Veli Deda , ,I biriIMisimit,dt.23.05.1962,,lindur neDiber,banues ne Peshkopi,Lagja e Re ne baze te Legjislacionit Shqiptar,vendosa:

**NENI 1:**
Te themeloj nje shqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar,per te ushtruar, Veprimtari ekonomike,e emeruar "DEDA"SH.P.K,me Ortak te Vetem, z.Veli Deda

**NENI 2:**
Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregtare me pergjegjesi te kufizuar Dhe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themeltar.

**NENI 3:**
Shoqeria e ka Seline e saj ne Peshkopi.,Lagja e Re.
Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise,filiale,agjensi,perfaqesi,seli sekondare dhe ti suprimoje ato.

**NENI 4:**
Shoqeria do te kete nje kohezgjatje me nje kufi te pacaktuar,mbi 15 vjet.
Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me Vendim te Ortakut te Vetem.

**NENI 5:**
Kapitali fillestar themelor I Shoqerise do te jete100.000(njeqindmije)leke.
Kapital I cili eshte I formuar teresisht nga Ortaku I vetem themelues I saj.

**NENI 6:**
Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregtare do te shenohet dhe kapitali I derdhur nga Ortaku.
Rritja e kapitalit te Ortakut nuk eshte e kufizuar.

**NENI 7:**
Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga Ortaku I Vetem I Shoqerise.

**NENI 8:**
Objekti I Aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:
.-Roje Civile.
-Ruajtja e Objekteve,civile e ushtarake.
-Ruajtja e,personave fizike e juridike,vendas e te huaj

**NENI 9:**

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit,qe lidhet midis paleve,ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7961 date 12.07.1995(Kodi I Punes).si dhe te akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

**NENI 10 :**

Ortaku I vetem nuk kufizohet ne rritjen e kapitalit te shoqerise..

**NENI 11:**

Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper te drejta dhe detyrime,vetem brenda kufirit te kapitalit te saj.Ortaku I vetem themelues mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne shoqeri.

**NENI 12 :**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private, Te shoqerise,midis punonjesve brenda saj si dhe me te tretet,kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim ,ceshtja mbetet ne kopetencen e Gjykates se Rrethit Tirane,ku do te jete dhe rregjistri tregtar I saj.

**NENI 13:**

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit te saj.

**NENI 14:**

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet prane Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

**NENI 15 :**

Organet e Shoqerise "DEDA" SHPK,jane:

_Ortaku I vetem I Shoqerise.

Administratori I Shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre,do te percaktohen ne Statutin e shoqerise.

-**Administrator** I Shoqerise do te jete z.VELI DEDA

Modalitete per ndryshimin e Administratorit si dhe kopetencat e tij rregullohen nga Statuti I Shoqerise dhe Ligji 7638 date 19.11.1992. "Per Shoqerite Tregtare".

-Ky Akt-Themelimi eshte perpiluar ne keter kopje,me vlere te njejte me origjinalin.

-dt:18.01.2001

**THEMELUESI**

**I SHOQERISE TREGTARE "DEDA"SHPK**

VELI DEDA

# S T A T U T
# I SHOQERISE TREGTARE
# ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# "DEDA" SH.P.K

Shoqeria "DEDA"SHPK,eshte krijuar mbi bazen e Aktit te Themelimit,teOrtakut te vetem,VELI DEDA ,I biri I Misimit,I datelindjes 23.05.1962,lindur ne Diber banues ne Peshkopi,Lagja "e Re",per te zhvilluar aktivitet tregtar ne fusha te ndryshme,I cili ka vendosur kete Statut si me poshte:

## EMERTIMI

**NENI 1**

Shoqeria eshte quajtur "DEDA"SHPK.

Ajo eshte nje person juridik shqiptar,I cili do te ushtroje aktivitet privat ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise,pas rregjistrimit ne Rregjistrin Tregtar,prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Shoqeria "DEDA"SHPK,zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e Themelimit te saj(Akt Themelimi e Statuti).

Ortaku I vetem themelues ne kete sipermerrje ke derdhur kapitalin e tij me Qellim qe te perfitoje te ardhura ,qe mund te vijne nga ushtrimi I veprimtarise private,si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres,se derdhur ne kapitalin themeltar.

**NENI 2:**

Objekti I aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

--Roje Civile-

-Ruajtja e Objekteve Civile e Ushtarake.

-Ruajtja e personave fizike e juridike vendas e te huaj.

**NENI 3:**

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria do te hapi njesi grumbulluese,perpunuese,sherbimi e trgtimi,duke bashkepunuar me persona fizike e juridike,vendas ose te huaj.

## S E L I A

**NENI 4:**

Shoqeria "DACI"SHPK,e ka seline e saj,ne Peshkopi.

Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise,dege,filiale,agjenesi perfaqesimi,si dhe ti suprimoje ato.

## KOHEZGJATJA E SHOQERISE

**NENI5.**

Shoqeria Tregetare Private “DACI” SH.P.K do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saje ekonomike me nje kufi te pacaktuar mbi 15 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe per cfardo shkaku .

## KAPITALI I SHOQERISE

**NENI 6.**

Kapitali fillestar I shoqerise eshte 100.000 (njeqinde mije ) leke e perbere nga kuota e ortakut te vetem themelues. Kapitali themeltar I shoqerise eshte I formuar teresisht nga themeluesi I saj Z.VELI DEDA

**NENI7.**

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesishte te transferueshme ne rruge trashigimie,ne raste ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve,paraardhesve ,dhe pasardhesve .Te gjitha pjeset e kapitalit te shoqerise mund te kalojne ,tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne ortakeri por gjithmone me vendim te ortakut te vetem dhe me akt noterial .

Trashigimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet.

**NENI 8.**

Kapitali I shoqerise perbehet nga kapitali themelor,dhe te tjera te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise tregtare .Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaku I vetem I shoqerise .

**NENI 9.**

Fitimi I realizuar nga ushtrimi I veprimtarise ekonomike I shoqerise do te administrohet nga ortaku I vetem.Nje pjese te ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar .Shoqeria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve .

## ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQERI

**NENI 10.**

Organi vendimor jane:

Vendimet e ortakut te vetem qe zevendeson asamblene e ortakeve .

Ortaku I vetem ka te gjitha te drejtat qe ka asambleja e ortakeve.

Ortaku I vetem vendos per ceshtje te tilla shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve ,miratimin I raporteve te administrimit dhe kontrollit miratimin llogarive, ndryshimet ne statut,zvogelimin e kapitalit themelor ose zmadhimin e tij, transferimin e pjeseve te kapitalit themelor tek te tretet. Te veprimtarise se shoqerise apo likujdimi I saj, shnderimi I shoqerise ne nje forme tjeter ne nje nga format e parashikuara nga ligja ndryshimi i vendqendrimit te selise .

NENI 11.
Ortaku I vetem mbledhjet e zakoneshme I ben cdo vit brenda kater muajve nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

## ADMINISTRATORI.

**NENI 12.**

-Administratori qendron per nje periudhe 3 vjecare ne detyre.
-Mandati I tij mund te jete I rinovueshem,Ortaku gezon te drejten ,ne cdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij .
-Administratori mundet ne cdo moment te emeroje nje zevendes ,ta revokoje,dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij.
-Administratori ka keto kopetenca:
Percaktimin e orientimeve kryesore te programit dhe buxhetit.
Aprovimin e planeve dhe te llogarive,ekonomike pas perpunimit te tyre ne baze te objektit te aktivitetit te shoqerise.

## VITI FINANCIAR ,LLOGARITE VJETORE,DHE REZERVA E DOMOSDOSHME

**NENI 13:**

Cdo vit financiar fillon ne 1 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor,me perjashtim te vitit te pare,ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise.

**NENI 14:**

Llogarite vjetore,inventaret,raportet,mbi operacionet e vitit financiar,dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret,apo nga ekspertet kontabel miratohen,nga ortaku I vetem,miratimi I dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3 mujor te mbylljes se vitit financiar.

**NENI 15:**

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit mund te krijoje dhe fonde te tjera.
Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal,afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore,etj.Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane Bankave te vendit dhe te kyeje veprime likujdimi me to.

## MARREDHENIET E PUNESIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE

**NENI 16:**

Maredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen ,nepermjet kontrates se punesimit,qe lidhet midis paleve ne perputhje me Ligjin,Nr.7961,date

12.07.1995,(Kodi I Punes).si dhe Legjislacionit tjeter Shqiptar qe ben fjale per punesimin.

**NENI 17:**

Marria ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi,ne librin e punes se Shoqerise,si dhe duke njoftuar organet e punes se juridiksionit ku ushtron veprimtarine shoqeria.

**NENI 18:**

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes per shkelje disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit,

Largimi nga Shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare .

Ndryshimi dhe largimi nga vendi I punes behet ne baze te Akti me shkrim,leshuar nga Ortaku I vetem themelues.

**NENI 19:**

Shoqeria mund te lidhe Kontrata me Sektore shteterore,si dhe me persona fizike ose juridike,vendas ose te huaj.

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga Ortaku I vetem I saj,ose nga nje person tjeter I autorizuar,prej tij me prokure.

Te drejtat dhe Detyrimet qe rrjedhin nga Kontratat,jane te detyrueshme per shoqerine.

**Neni 20:**

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj,per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimet deri ne fund dhe I paraqesin ortakut te vetem,dhe administratorit rezultatet perfundimtare te likujdimit .Ne perfundim ortaku I vetem vendos per heqjen e mandatit te tyre.Te gjitha detyrimet qe dalin nga likujdimi Ortaku I vetem dhe Administratori I merr,persiper per tu shlyer me kapitalin e tij.

**NENI 21:**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te kalojne ne kopetence te Gjykates se Rrethit Tirane.

**NENI 22:**

Transferimi I Shoqerise nga nje forme ne nje tjeter behet me vendim te Ortakut te vetem,kur plotesohen kushtet per krijimin e Shoqerive te llojeve te tjera.

**NENI 23:**

Themeluesi I Shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore ne cdo kohe ,me Nenet e pershkruara ne kete Statut.

Ndryshimet e plotesimet behen ne te njejten menyre dhe procedure ,me te cilen nxirret vete Statuti.

**NENI 24:**

Ceshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete Statut ,gjithcka I referohet Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992,Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993,si dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi,si dhe Akteve te tjera Ligjore dhe Nenligjore, Te dala ne zbatim te tyre.

**NENI 25:**

Ky Statut eshte perpiluar dhe firmosur ne kater kopje me vlere te njejte me origjinalin.

Dt:18.01.2001

**ORTAKU VETEM THEMELUES I**
**DHE ADMINISTRATOR**
VELI DEDA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
**NR. 376 REP**
**NR. 27 KOL**

# VERTETIM

Vertetohet se sot me date: 18.01.2001 (dymije e nje),
Personalisht para meje Noteres Fatmara Shehu
:Shtetasi si me poshte:
VELI DEDA:I biri I Misimit dtl.23.05.1962 lindur ne,Diber,banues ne Peshkopi,"Lagja e Re"

I cili ka hartuar kete Akt Themelimi dhe Statut per Rregjistrimin si person Juridik te Shoqerise themeluar prej tij "DEDA"SH.P.Kdhe depozitimin ne Zyren e Rregjistrin Tregtar.Konform Ligjit per "Shoqerite Tregtare"

Madhor me zotesi te plote per te vepruar.

Une Notere e gjej kete kerkese sipas Ligjit ne Fuqi.
Duke e gjetur konform Ligjit e nenshkruaj rregullishtsipas Ligjit

**NOTERE**
**FATMARA SHEHU**

PULLE TAKSE 50 LEKE R. SHQIPERISE

NOTER TIRANE

25003/11

**KERKESE**

**Kerkues: Veli DEDA**, i biri i Misimit, lindur ne Diber, me 23.05.1962, banues ne Peshkopi, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "DEDA" SH.P.K.
**Objekti:** Depozitim ne rregjistrin tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem te Shoqerise "DEDA,,SH.P.K. date 19.043.2005
**Baza ligjore:** Ligji n.7638 date 19.11.1992 dhe ligji 7667 date 28.01.1993.

**PER KOMPETENCE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE**

Ortaku i vetem i shoqerise "DEDA" SHPK, ne date 19.04.2005 vendosi:

1. Ndryshimin e emrit te shoqerise nga "DEDA" ne "KEVENJO" SHPK.
2. Emerimin e Z. Ismet Sadik CANI ne detyren e drejtuesit teknik te shoqerise.
3. Rritjen e kapitalit te shoqerise nga 100.000 leke ne 4.000.000 leke.
4. Zgjerimin e objektit te shoqerise me: Ushtrim aktiviteti te sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike kategoria A+B

Ne cilesine e Administratorit te Shoqerise, kerkoj te depozitoj ne rregjistrin tregtar vendimin e lartpermendur.

Të depozitohet kërkesa dt 20.04.05

**ADMINISTRATOR**

Veli Deda

**VELI DEDA**
**DEDA SHPK**

Vendimi i Ortakut të Vetëm dt 19.04.05

**Notere Gentiana Shkodra**
**M.Shyri, P. 44, sh.1, Ap.1**
**Dhoma e Noterise Tirane**

**N....578....rep**

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot me date 19.04.2005 para meje Notere Gentiana Shkodra, ne qytetin e Tiranes, u paraqit: **Veli DEDA**, i biri i Misimit, lindur ne Diber, me 23.05.1962, banues ne Peshkopi, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "DEDA,,SH.P.K., personalisht i njohur prej meje, i cili ne pranine time nenshkroi kete kerkese drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare Tirane. Vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**GENTIANA SHKODRA**
**NOTERE**

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

**DEDA SHPK**
Tirane

---

**VENDIM I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE**
**"DEDA„SHPK**

Sot me date 19.04.2005, une ortaku i vetem i shoqerise DEDA SHPK

**VENDOSA:**

1. Ndryshimin e emrit te shoqerise nga "DEDA" ne "KEVENJO" SHPK.
2. Emerimin e Z. Ismet Sadik CANI ne detyren e drejtuesit teknik te shoqerise.
3. Rritjen e kapitalit te shoqerise nga 100.000 leke ne 4.000.000 leke.
4. Zgjerimin e objektit te shoqerise me: Ushtrim aktiviteti te sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike kategoria A+B
5. Depozitimin e ketij vendimi prane Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Sa me lart nenshkruhet prej nesh :

**PER SHOQERINE « DEDA» SHPK**

**VELI DEDA**

**Notere Gentiana Shkodra**
**M.Shyri, P. 44, sh.1, Ap.1**
**Dhoma e Noterise Tirane** **N....349....rep**

---

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot me date 19.04.2005 para meje Notere Gentiana Shkodra, ne qytetin e Tiranes, u paraqit: Veli DEDA, i biri i Misimit, lindur ne Diber, me 23.05.1962, banues ne Peshkopi, ne cilesine e ortakut dhe adminsitratorit te Shoqerise "DEDA„SH.P.K. , personalisht i njohur prej meje, i cili ne pranine time nenshkroi kete vendim te ortakut te shoqerise. Vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**GENTIANA SHKODRA**
**NOTERE**



**RAIFFEISEN BANK Sh.A**

**DEGA RAJONALE BURREL**
**AGJENSIA BULQIZE**

**Bulqize me__________**

## V E R T E T I M

Me ane te cilit vertetojme se z. Veli DEDA eshte klient I agjencise sone me nr.llogarie 0001867853 dhe likujditete ne shumen 4.000.000 ( katermijlion) lek. E leshojme kete vertetim sipas kerkeses se interesuarit.

Ezmerina HOXHA

Pergjegjese Agjencie




Republika e Shqiperise
Dhoma e Noterise Tirane
Rep 558 date 15.4.07
VERTETOHET
njesia me origjinalin

3 Blerime [illegible] 12 DHJETOR 2005
12 12 2005

25003/2

# KERKESE

**Kerkues: Veli DEDA,** ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "KEVENJO"SH.P.K.
**Objekti:** Depozitim ne rregjistrin tregtar te Vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise "KEVENJO,,SH.P.K. date 07.12.2005
**Baza ligjore:** Ligji n.7638 date 19.11.1992 dhe ligji 7667 date 28.01.1993.

**PER KOMPETENCE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

Ortaku i vetem i shoqerise "KEVENJO" SHPK, ne date 07.12.2005 vendosi:

1. Emerimin e Z. Selman Hysen NELA, lindur ne Rec, Diber, me 16.08.1947, bnaues ne Tirane, rruga Tasim Shehu, si drejtues teknik i shoqerise meqenese drejtuesi I meparshem teknik Ismet Sadik CANI ka nderruar jete.
2. Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ne cilesine e Administratorit te Shoqerise, kerkoj te depozitoj ne rregjistrin tregtar vendimin e lartpermendur.

Te depozitohet kerkesa dt 15.12.05
Vendimi: Gjyqtari
Ordim dt 17-12-05

**ADMINISTRATOR**

Veli Deda

**VELI DEDA**
**KEVENJO SHPK**

**Notere Gentiana Shkodra**
**M.Shyri, P. 44, sh.1, Ap.1**
**Dhoma e Noterise Tirane** **N.**2671**.rep**

## VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 07.12.2005 para meje Notere Gentiana Shkodra, ne qytetin e Tiranes, u paraqit: Veli Deda, i biri i Misimit, lindur ne Diber, me 1962, banues ne Tirane, rruga Don Bosko, me zotesi te plote juridike per te vepruar, personalisht i njohur prej meje, ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "KEVENJO.,, SH.P.K., i cili ne pranine time nenshkroi kete kerkese drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**GENTIANA SHKODRA**
**NOTERE**

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

**KEVENJO SHPK**
**Lagjia e Re, Peshkopi**

**VENDIM I ORTAKUT TE VETEM**

**TE SHOQERISE KEVENJO SHPK**

Sot me date 07.12.2005, une ortaku i vetem i Shoqerise "KEVENJO „ shpk, Shoqeri e krijuar me vendimin nr 25003 te vitit 2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, Veli DEDA,

**VENDOSA:**

1. Emerimin e Z. Selman Hysen NELA, lindur ne Rec, Diber, me 16.08.1947, banues ne Tirane, rruga Tasim Shehu, si drejtues teknik i shoqerise meqenese drejtuesi i meparshem teknik Ismet Sadik CANI ka nderruar jete.
2. Depozitimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Sa me lart nenshkruhet lirisht prej meje:

**VELI DEDA**
**KEVENJO SHPK**

**Notere Gentiana Shkodra**
**M.Shyri, P. 44, sh.1, Ap.1**
**Dhoma e Noterise Tirane** **N...0672...rep**

---

**VERTETIM NENSHKRIMI**

Sot me date 07.12.2005 para meje Notere Gentiana Shkodra, ne qytetin e Tiranes, u paraqit: Veli Deda, i biri i Misimit, lindur ne Diber, me 1962, banues ne Tirane, rruga Don Bosko, me zotesi te plote juridike per te vepruar, personalisht i njohur prej meje, ne cilesine e ortakut te vetem te Shoqerise "KEVENJO.„ SH.P.K., i cili ne pranine time nenshkroi kete vendim te ortakut te vetem te shoqerise. Vertetoj nenshkrimin e tij sipas ligjit.

**GENTIANA SHKODRA**
NOTERE



25003/3

05 DHJ. 2006

# KERKESE

**Kerkues: Veli DEDA,** ne cilesine e Administratorit te Shoqerise "KEVENJO" Sh.p.k.

**Objekti:** Depozitim ne rregjistrin tregtar te Vendimit te Ortakut te vetem te Shoqerise "KEVENJO,,Sh.p.k. date 16.11.2006

**Baza ligjore:** Ligji n.7638 date 19.11.1992 dhe ligji 7667 date 28.01.1993.

**PER KOMPETENCE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE**

